



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 350 Prot.

Tiranë, më datë 15.07 2026

VENDIM
Nr. 90, datë 15.07.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sajt”, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 75 datë 19.02.2020 “Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 15.07.2026, Këshilli Teknik:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor hartuar në kuadër të projektit “Kompleks rezidencial, shërbime, qendër biznesi dhe hoteleri (Riverway City), me 1, 2, 15-21, 23, 27 kate, me 2 kate nëntokë”, njësia administrative Kashar, rruga “Pjetër Bogdani”, me zhvillues subjekti “**Fratari Construction 1990**” sh.p.k.;
2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Kompleks rezidencial, shërbime, qendër biznesi dhe hoteleri (Riverway City), me 1, 2, 15-21, 23, 27 kate, me 2 kate nëntokë”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijoje me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR I KT
Endri HAXHIU